

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE "THORENEKS" Sh.p.k**



Ne Korçe, sot me dt.02.03.2002, bazuar ne ligjin 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", me cilesine e themeluesave:

1. Thoma Xega, i biri i Jorgjit i dtl.23.01.1967, lindur dhe banues ne Mborje Korçe me nr. Pasaporte 1811477.
2. Aurel Xega, i biri i Jorgjit, i dtl.03.02.1969, lindur dhe banues ne Mborje Korçe me nr pasaporte 1172094.

Vendosem te themelojme shoqerine tregetare "Thoreneks" Sh.p.k , si me poshte:

NENI 1

Themelohet shoqeria tregetare "Thoreneks" si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 2

Shoqeria do te kete si object veprimtarie te saj:

- Prodhim dhe tregetim betoni dhe parafabrikatesh per ndertim objektesh.
- Prodhim dhe tregetim materialesh inerte
- Tregeti e pergjitheshme import eksport, me shumice dhe pakice, e materileve te ndryshme te ndertimit, hidraulike, hidrosanitare, elektrike, etj.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e vet tregetar ne rrethin e Korces, dhe konforme dispozitave te statutit do te hape dege dhe filiale te saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

NENI 4

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e vet tregetar per nje periudhe prej 15 vjetesh. Me vendim te organeve te shoqerise kjo periudhe mund te shtohet apo te zvogelohet.

NENI 5

Shoqeria do te kete seline e vet ne qytetin e Korces, ne km 1, te rruges Korçe Bilisht, ne krahun e djathte te saj.

NENI 6

Kapitali I shoqerise perbehet nga kontributi ne natyre dhe kontributi ne te holla. Kontributi ne natyre eshte ne vleren 22.638.200 leke. Kontributi ne te holla eshte ne vleren 100.000 leke. Kontributi i secilit ortak ne krijimin e ketij kapitali themeltar eshte :

- Per ortakun Thoma Xega 55 %
- Per ortakun Aurel Xega 45 %.

Kontributi i secilit ortak eshte vleresuar nga nje ekspert kontabel, i ngarkuar nga ne themeluesit per kete qellim.





NENI 7

Fitimi qe do te rezultoje nga veprimtaria tregtare e shoqerise do te ndahet ndermjet ortakeve te saj sipas kontributit te tyre ne krijimin e kapitalit themeltar te shoqerise. Fitimi ndahet midis ortakeve mbasi shoqeria ka shlyer te gjitha detyrimet e veta fiskale, doganore administrative, si dhe ndaj te treteve. Fitimi i ndare eshte lirisht i disponueshem nga ana e ortakeve.

NENI 8

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve
- Administratori

Kopetencat e asamblese se ortakeve ,dhe te administratorit regullohen nga statuti i shoqerise dhe nga ligji 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

NENI 9

Shoqeria do te respektoje dispozitat ligjore per te punesuarit ne shoqeri.

NENI 10

Konfliktet qe do te lindin nga veprimtaria tregtare e shoqerise ndermjet ortakeve kur nuk zgjidhen me pajtim ,zgjidhen ne rruge gjyqesore. Gjykata kopetente eshte gjykata e rrethit Korce.

ORTAKET THEMELUES

THOMA XEGA


AUREL XEGA

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE KORCES
NR.493Rep.
Nr.231Kol.

Ne kopjen e mbajtur nga noteri
jane aplikuar pullat e takses.

Vertetim - Neneshkrimi

Ne qytetin e korces sot me daten 4.04.02, para meje Sotiraq Guri Qafzezi me detyren e noterit ne dhomen e noterise Korces u paraqiten personalisht THOMA JORGJI XEGA me datlindje 23.01.1967 me pashaporte Nr.1811477, si dhe AUREL JORGJI XEGA me datlindje 302.1969, me nr. pashp.1172094, te dy madhore te afte per te kryer veprimet juridike te cilet deklaruan se jane dakort me permbajtjen e kontrates se Themelimit te shoqerise dhe firmosen para meje noterit.....



NOTERI

Sotiraq Guri Qafzezi

STATUT I SHOQERISE "THORENEKS" Sh.p.k

I hartuar ne baze te

- Ligjit 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregetare"
- Ne mbeshtetje te vullnetit te ortakeve themelues te shprehur ne aktin e themelimit



KAPITULLI I

FORMA LIGJORE, EMERTIMI, SELIA

NENI 1

Shoqeria "Thoreneks" eshte nje shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar, ndertimi dhe funksionimi i se ciles eshte ne pajtim te plote me dispozitat e ligjit 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

NENI 2

Emri i plote i saj me te cilen shoqeria do te dale ne qarkullimin civil eshte :
Shoqeria "Thoreneks" Sh.p.k

NENI 3

Shoqeria do te kete seline e vet ne qytetin Korce, ne km. 1 te rruges nacionale Korce-Bilisht, ne krahun e djathte te saj.

Qendra e veprimtarise se shoqerise eshte ne qytetin Korce. Shoqeria me vendim te organeve te saj mund te hape dege dhe filiale ne rrethe te tjera te Republikes se Shqiperise.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqeria ka objekt te veprimtarise se vet tregetare:

- Prodhim dhe tregetim betoni dhe parafabrikatesh per ndertim objektesh
- Prodhim dhe tregetim materialesh inerte
- Tregeti e pergjitheshme import dhe eksport me shumice dhe pakice e materialeve te ndryshme te ndertimit, hidraulike, hidroshifare, elektrike, etj.

NENI 5

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e vet tregetar per nje periudhe prej 15 vjetesh. Kjo periudhe mund te zgjatet me vendim te asamblese se ortakeve.

Shoqeria mund te mbylle aktivitetin e vet tregetar para ketij afati kur kjo vendoset nga asambleja e ortakeve per shkaqe qe nuk motivojne vazhdimesine e veprimtarise tregetare.





NENI 6

Shoqeria ka te drejte te marre kredi nga cdo banke qe ushtron aktivitetin e vet ne territorin e Republikes se Shqiperise,ne ushtrimin e aktivitetit te vet ekonomik ne funksion te arritjes se qellimeve te veta.

NENI 7

Ortaket jane te lire te marrin pjese ne shoqeri te tjera tregtare,dhe te disponojne lirisht fitimet qe do te ndahen nga kjo shoqeri.

KAPITULLI 2 TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI 8

Ortaket gezojne keto te drejta kryesore,te cilat I ushtrojne nepermjet vendimeve qe merr asambleja e ortakeve:

- Administrojne teresisht veprimtarine prodhuese,tregtare, ekonmike dhe financiare te shoqerise.
- Marrin ne cdo kohe ,te dhena mbi gjendjen e kapitalit dhe llogarive ekonomike te shoqerise.
- Marrin pjese vet, ose me ane te perfaqesuesve te tyre,ne operacionet prodhuese dhe tregtuese te shoqerise.
- Terheqin ne cdo kohe dokumentacionin kryesor te shoqerise si raportin e administrimit,iventaret e ndryshem dhe llogarite vjetore per tre vitet e fundit kalendarike.
- Kerkon shpjegime per cdo material te paraqitur ne mbledhjen e asamblese se ortakeve dhe kontrollon dokumentat shoqeruese te materialit.
- Merr nga administratori 15 dite para mbledhjes ,raportin e administrimit dhe projektin e vendimeve qe do te shqyrtoje mbledhja e ortakeve.
- Shfaq mendim personal per problemet qe diskutohen dhe vendosen ne mbledhjen e asamblese se ortakeve.
- Heq dore nga shoqeria ne kushtet e parashikuara ne kete statut.

NENI 9

Ortaket kane keto detyrime kryesore:

- Depozitojne brenda afatit te kerkuar kapitalin themelor ne te holla,ose vene ne dispozicion te shoqerise kapitalin ne natyre sipas kontrates se themelimit.
- Depozitojne brenda afatit te caktuar fondet qe rjedhin nga vendimet e asamblese per rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Te zbatoje vendimet e marra nga mbledhja e asamblese se ortakeve kur vendimi eshte mare me kuorumin e kerkuar dhe permban nje detyrim per te.
- Cdo lloj detyrimi qe rrjedh per ortakun personalisht i parashikuar nga ligji 7638 dt.19.11.1992 .



NENI 10

Ortaku mund te heq dorë nga shoqeria ne cdo kohe,per cfaredolloj shkak,me kusht qe te lajmeroje per kete veprim ortaket e tjere te shoqerise 6 muaj me pare .
Heqja dore nga shoqeria,nuk e liron ortakun nga detyrimet qe ka krijuar shoqeria deri ne ato momente,dhe ka te drejte te perfitoje nga fitimet e realizuara nga veprimtaria tregtare deri ne ate periudhe.

NENI 11

Ortaku mund te shese pjese te kapitalit te tij ne shoqeri,ose gjithë kapitalin qe ai zoteron ne te.Per kete veprim ai detyrohet te njoftoje me shkrim, ortaket e tjere te shoqerise,per projektin e shitjes duke i ofruar dhe cmimin perkates.
Shitja e ketij kapitali ne persona te trete jashte shoqerise lejohet vetem kur,ortaket,me shkrim, kane refuzuar te blejne kete kapital sipas cmimit te ofruar.
Ndalohet shitje e ketij kapitali ne persona te trete,me kushte me te favorshme se sa ato qe u jane ofruar ortakeve te shoqerise.

NENI 12

Ndalohet emetimi i letrave me vlere nga ana e shoqerise.
Cdo mareveshje ne kundershtim me kete dispozite eshte e pavlefshme.

KAPITULLI 3

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 13

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kapitali ne natyre dhe nga kapitali ne te holla.

Kapitali ne natyre eshte ne vleren 22.638.200 leke

Kapitali ne te holla eshte ne vleren 100.000 leke.

Pjesa qe zoteron secli ortak ne kete kapital eshte pasqyruar ne aktin e themelimit te kesaj shoqerie.

NENI 14

Kapitali i secilit ortak eshte lirisht i trasferueshem te ortaket e tjere ,ne rruge trashegimie etj.


Subjektet qe perfitojne nga ky trasferim detyrohen te disponojne kapitalin e perfituuar per nevojat e shoqerise ,duke permbushur te gjitha detyrimet qe ligji 7638 dt. 19.11.1992 parashikon per ortaket.

NENI 15

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te asamblese se ortakeve.

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit behet duke respektuar parimin e perpjesetueshmerise . Kjo nenkupton ruajtjen e raporteve te ortakeve ne kapitalin themeltar para dhe pas zmadhimit apo zvogelimit te kapitalit.

Ortaket kane te drejte te heqin dore nga parimi i mesiperm,duke njoftuar me shkrim ortaket e tjere se nuk deshirojne te perfitojne nga kjo e drejte.



NENI 16

Shoqeria mund të krijojë një fond rezerve të vetin, madhesia e të cilit nuk mund të kalojë 1/10 e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Me anën e këtij fondi shoqëria shlyen detyrimet e saj ndaj të tjerëve.

NENI 17

Shoqëria e ushtron aktivitetin e vet ekonomik në baze të planit të vet ekonomik-financiar për arrijnjen e qëllimeve të caktuara.

Dokumentacioni kontabel mbahet në seline të shoqërisë dhe kopje të tij vihet në dispozicion të ortakëve sa herë ata me kërkesë me shkrim i drejtohen organeve të shoqërisë për një gjë të tillë.

KAPITULLI 4 ADMINISTRIMI

NENI 18

Organi vendimor i shoqërisë është mbledhja e asamblese së ortakëve.

Asambleja e ortakëve mbledhet në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Në mbledhjet e jashtëzakonshme të asamblese së ortakëve diskutohen dhe vendoset për çështje që kanë të bëjnë me dispozitat e statuti dhe për çështje që kanë të bëjnë me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

Asambleja e jashtëzakonshme mer vendime nëse për çështjen konkrete kanë marrë pjesë në mbledhje dhe kanë votuar ortakët që zoterojnë 3/4 e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Asambleja e zakonshme diskuton për probleme të administrimit të përditshëm të veprimtarisë së shoqërisë.

Asambleja e zakonshme diskuton dhe mer vendime kur për çështjen konkrete kanë votuar ortakët që zoterojnë 1/2 e kapitalit themeltar.

NENI 19

Asambleja e zakonshme thirret nga administratori i shoqërisë duke njoftuar ortakët për ditën vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes përkatëse.


Për mbledhjen e jashtëzakonshme të shoqërisë duhet të respektohen dispozitat e ligjit 7638 dt.19.11.1992.

NENI 20

Administratori i shoqërisë është ortaku Aurel Xega.

Administratori përfaqëson shoqërinë në të gjithë veprimtarinë e vet dhe ka këto kompetenca:

- Miraton llogaritë ekonomike pas përfundimit të tyre nga administrata.
- Përgatit raportin vjetor për veprimtarinë e shoqërisë dhe ja paraqet asamblese së ortakëve
- Siguron zbatimin e vendimeve të marra nga mbledhja e ortakëve.
- Propozon para mbledhjes së asamblese propozimet për ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Propozon në mbledhje mundësinë e krijimit të degëve, filialeve apo zyrave të shoqërisë në territorin e R. Shqipërisë.



- Propozon mundesine e krijmit te organeve te tjera per permirsimin e punes se shoqerise.
- Lidh kontratat e punes me te punesuarit ne shoqeri.
- Perfageson shoqerine ne organet administrative,gjyqesore,doganore etj
- Neneshkruan ne emer te shoqerise kontratat ,pervec atyre qe asamblea i gjykon ne kopetence te saj.

Administratori mban pergjegjesi perpara ortakeve per veprimet e kryera prej tij me faj dhe ne dem te shoqerise.

Shoqeria mer persiper aktet e administratorit gjate realizimit te veprimatrise se tij.

NENI 21

Shoqeria mund te caktoje ekspert kontabel te autorizuar per cdo vit financiar te cilet emerohen nga asambleja e ortakeve.

Ekspertet kontabel mbajne pergjegjesi sipas dispozitave ligjore gjate ushtrimit te detyres se tyre.

Eksperte kontabel i autorizuar nuk mund te jete nje person qe ka nje pengese ligjore.

NENI 22

Maredheniet e punes ne shoqeri regullohen nga legjislacioni shqiptar i punes.

Cdo te punesuari ne shoqeri i lidhet kontrata lindivduale e punes.

KAPITULLI 5

MBYLLJA DHE LIKUJDIMI

NENI 23

Shoqeria do te vazhdoje aktivitetin e vet per periudhen 15 vjecare nga dita e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregetar.

Veprimtaria e saj mund te nderpritet me propozim te nje ortaku ne rast se:

- Nuk rezulton rentabile gjate 2 viteve te fundit te veprimtarise se saj ekonomike
- Kur per te vendoset me unanimitet nga ortaket e shoqerise.

NENI 24

Kur vendoset shkrijja e shoqerise asambleja cakton nje likujdator i cili i paraqet asaj bilancin e likujdimit.

Shoqeria gjate likujdimit te saj mban shenimin "shoqeri ne likujdim e siper"

Ortaket mblidhen ne fund te procesit te likujdimit per te vendosur lidhur me bilancin perfundimtar,aktin e rregullshmerise se likujdimit dhe per heqjen e mandatit te likujdatorit.

Pas mbylljes se procesit te likujdimit dhe depozitimit te dokumentave ne rregjistrin tregetar,shoqeria cregjistrohet prej tij.

KAPITULLI 6

DISPOZITA TE FUNDIT



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

NENI 25

Likujdatori është pergjegjes per demet qe i shkakton shoqerise gjate ushtrimit te detyres se tij

Ai pergjigjet per demet qe u ka shkaktuar ortakeve, dhe te treteve, gjate periudhes se likujdimit kur ka vepruar si likujdator.

Padia kunder likujdatorit parashkruhet sipas pashikimeve ne ligjin 7638 dt.19.11.1992.

NENI 26

Te gjitha te punesuarit ne shoqeri, dhe te ngarkuarit me plotesimin e detyrave konkrete mbajne pergjegjesi penale sipas dispozitave perkatese te ligjit 7638 dt.19.11.1992, per rastet e parashikuara ne kete ligj.

NENI 27

Dispozitat e ligjit 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" do te zbatohen vetem ne ato raste kur statuti hesht apo nuk e rregullon ne menyre direkte nje ceshtje konkrete.

ORTAKET E SHOQERISE

THOMA XEGA

AUREL XEGA

Republika e Shqiperise
Dhoma e Noterise Korces
Nr.494 Rep.
Nr.232 Kol.

Ne kopjen e pare mbajtur nga noteri
jane vendosur pullat e takses.

Vertetim - Meneshkrimi

Ne qytetin e korces sot me daten 4.04.02 para meje Notiraq Guri Qafzezi me detyren e noterit ne dhosen e noterise kercen u paraqiten per sonalisht THOMA JORGJI XEGA me datlindje 23.01.1969 me pashaporte : 1811477, ai dhe AUREL JORGJI XEGA me dat.1.3.02.1969, me pashp.1172094, te dy madhore te afte per te kryer veprime juridike te cilet deklaruan se jane dakort me permbajtje e Statutit te firmosur prej tyre para meje noterit.....

NOTERI

Notiraq Guri Qafzezi

